



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**MUNDËSI APLIKIMI NË POLONI NË KUADËR TË PROGRAMIT TË
BURSAVE “STEFAN BANACH”**

VITI AKADEMIK 2020-2021

Qendra Institucionale për Frankofoninë në Poloni, në kuadrin e programit të bursave “Stefan Banach” ofron për vitin akademik 2020-2021 bursa në programin e studimit “Master” për shtetasit e huaj nga vendet e Azisë Qendrore dhe të Ballkanit Perëndimor. Programi i Bursave “Stefan Banach” është një iniciativë e përbashkët e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë dhe Agjencisë Kombëtare Polake për Shkëmbim Akademik (NAWA) dhe synon të mbështesë rritjen socio-ekonomike të vendeve në zhvillim.

Programi i Bursave u drejtohet qytetarëve të vendeve të identifikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me përparësi për t’u mbështetur me bursë studimi për Programin “Stefan Banach”, ku përfshihet edhe Shqipëria.

Programi ofron një mundësi për të ndjekur studime të ciklit të dytë Master me kohë të plotë, në fushat e inxhinierisë dhe shkencave teknike, bujqësore dhe natyrore në universitetet publike dhe jopublike në varësi të Ministrisë së Shkencës dhe Arsimit të Lartë të Polonisë. Përmes këtij programi kandidatët përfitojnë përjashtim nga tarifat e shkollimit dhe një bursë mujore, e cila akordohet nga Agjencia Kombëtare Polake për Shkëmbim Akademik (NAWA) gjatë periudhës së studimit në Poloni.

Programi zhvillohet në gjuhën polake ose angleze dhe aplikimi realizohet përmes sistemit online TIK të NAWA së bashku me dokumentet e ngarkuara. Afati i fundit është data 16 Mars 2020, (15:00 sipas orës lokale të Polonisë), i cili gjendet në faqen web: <https://programs.nawa.gov.pl/login>
<https://nawa.gov.pl/en/students/foreign-students/the-stefan-banach-scholarship-programme>;
<https://nawa.gov.pl/en/students/foreign-students/the-stefan-banach-scholarship-programme/call-for-proposals>.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**